



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

Drejtoria	<b>Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit</b>
Periudha Raportuese	<b>Dhjetor 2016</b>
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Drita Rudi dhe Valbona Gashi

#### 1. PËRMBLEDHJE

*Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.*

#### **Kulturë:**

- Gjatë muajit raportues janë realizuar shumë takime të planifikuara dhe të paplanifikuara me partnerë, palë të jashtme dhe kolegë nga drejtoria dhe Komuna. Drejtoria e Kulturës, si dhe institucionet vartëse, kanë realizuar planin operativ të punës, por edhe angazhime të tjera sipas nevojës.

#### **Rini dhe Sport:**

- Pas kërkesave të bëra në Drejtorinë e Investimeve Kapitale, në muajin dhjetor është realizuar ndarja fizike në mes të këndit të lodrave për fëmijë dhe QMF-së në lagjen "Kalabria". Kjo ndarje ka ndikuar në krijimin e hapësirës së përshtatshme për fëmijë, njëkohësisht edhe kopshtit të Qendrës së Mjekësisë Familjare.
- Këndet e lodrave për fëmijë në lagjet "Dardania", "Kodra e Diellit" dhe "Kodra e Trimave" janë në realizim e sipër, ku pranimi teknik pritet të bëhet në fillim të vitit 2017.
- Gjatë muajit dhjetor të vitit 2016, pas shpalljes së "Thirrjes për aplikim", në Sektorin për rini dhe sport janë pranuar kërkesa të ndryshme për financim, të cilat janë shqyrtuar nga komisioni i caktuar/ angazhuar nga Kryetari i Komunës, për ndarjen e subvencioneve në fushën e rinisë dhe sportit për fazën e fundit të vitit 2016.

- Bazuar në kërkesat dhe nevojat e shumta të klubeve sportive dhe OJQ-ve rinore për zhvillimin e aktiviteteve dhe realizimin e projekteve të tyre në përgjithësi, si Drejtori e Kulturës obligohemi që këtyre kërkesave t'u përgjigjemi dhe t'i përkrahim ato projekte të cilat janë në pajtueshmëri me politikat programore që mban Sektori.
- Pjesëmarrje në ceremoninë e nënshkrimit të *Udhëzimit administrativ për punë vullnetare për të rinj (UAPVR)*, pas përfundimit të procesit të plotësim-ndryshimit nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Udhëzimi administrativ për punë vullnetare për të rinj është produkt i Ligjit për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë.  
Plotësim-ndryshimi i UAPVR-së është përkrahur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Zyra e UNICEF-it në Kosovë, dhe është implementuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, gjegjësisht Departamenti i Rinisë.  
Ceremonia është organizuar më 5 dhjetor 2016, në amfiteatrin e madh të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës në Prishtinë.
- Komisioni i Kuvendit të Kosovës për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport, në bashkëpunim me Organizatën Demokraci Plus (D+), ka organizuar dëgjim publik për monitorimin e zbatimit të Ligjit për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë, ku pjesëmarrës ishin edhe zyrtarë nga DK-ja. Në këtë takim pjesëmarrës ishin edhe përfaqësues të Kuvendit të Kosovës, organizatave rinore, institucioneve komunale nga Prishtina, Fushe- Kosova, Obiliqi dhe Podujeva.

## 2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

### Kulturë:

- Realizimi i projektit "Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit";
- Puna e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për subvencionim në veprimtari të ndryshme dhe realizimi i pagesave ;
- Furnizimi i institucioneve kulturore vartëse me lëndë djegëse;
- Përpilimi i Formularit për aplikim për subvencione në fazat në vijim;
- Përpilimi i rregulloreve të brendshme të punës;
- Organizimi i koncerteve për promovimin e artistëve të rinj;
- Vlerësimi i ofertave për digjitalizimin e procesit të aplikimit për subvencione, realizuar në bashkëpunim me UNDP-në.

### Arkivi Komunal:

- Ka vazhduar punën sipas planit të punës në rregullimin e materialit arkivorë, duke iu përgjigjur 45 kërkesave të palëve lidhur me dokumentacionin e kërkuar nga ana e tyre.

Biblioteka "Hivzi Sulejmani":

- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare, klasifikimi dhe katalogimi i librit;
- Regjistrimi i anëtarëve të rinj, huazimi i librit dhe lidhja e gazetave, leximin dhe komentimin e librit, vizatime nga përmbajtja e librit, lojëra logjike, punë dore etj.;
- Postimi i materialeve dhe aktiviteteve në faqen e bibliotekës në ueb-faqe dhe "Facebook".

Teatri i qytetit të Prishtinës "Dodona":

- Gjatë muajit dhjetorë ka zhvilluar 88 aktivitete në skenën e fëmijëve dhe të mbrëmjes.

Qendra Kulturore e Fëmijëve:

- Klubi i Ambasadorëve të Rinj - përgatitja e performancës për festat e fundvitit dhe provat e rregullta me ambasadorët;
- Kori dhe solistet – përgatitja e programit për festat e fundvitit, si dhe provat e rregullta;
- Sektori i Sportit – përgatitja për zgjerimin e aktiviteteve në kuadër të sportit, për themelimin e grupit "Badminton".

### **Rini dhe Sport:**

- Finalizimi i subvencionimit të fazës së fundit për vitin 2016 për klubet sportive dhe OJQ-të rinore.
- Komisioni për organizimin dhe identifikimin e artistëve për pjesëmarrje në shënimin e festës së 28 Nëntorit dhe festave dhe organizimeve të tjera kulturore deri në fund të vitit 2016, i caktuar sipas Vendimit 01. nr. 031- 288107, dt. 23.11.2016, do të angazhohet në realizimin e aktiviteteve të fundvitit.
- Gjatë muajit dhjetor janë planifikuar të realizohen koncerte javore, me qëllim të promovimit të solisteve të rinj, të cilët kanë qenë të obliguar të aplikojnë paraprakisht. Për përzgjedhjen e tyre janë angazhuar Komisioni i lartëcekur.

### **3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA**

*Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtorja juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë*

### **Kulturë:**

- Solemnitetit me rastin e ndezjes së dritave të bredhit në sheshin Zahir Pajaziti, si dhe dekorimi i qytetit për festat e fundvitit;
- Puna e komisionit për vlerësimin e kërkesave të artistëve të rinj për promovimin në skenën e vendosur në sheshin "Zahir Pajaziti";
- Realizimi i 7 koncerteve për promovimin e artistëve të rinj. Kjo iniciativë u vlerësua lart nga pjesëmarrja e madhe e qytetarëve të të gjitha moshave. DK u dha mundësinë për të performuar, duke siguruar kushte sa më të mira për skenën, zërimin, ndriçimin dhe instrumentet e nevojshme të të gjithë aplikuesve që komisioni i vlerësoi.

- Furnizimi i 7 degëve të bibliotekave dhe teatrit “Dodona” me lëndë djegëse;
- Shqyrtimi i mbi 300 kërkesave për subvencionim nga 3 komisionie për veprimtari të ndryshme;
- Përpilimi i vendimeve dhe kontratave për subvencionim;
- Nënshkrimi i kontratave dhe realizimi i pagesave;
- Përpilimi i Formularit për aplikim për subvencione në fazat në vijim;
- Përpilimi i rregulloreve të brendshme të punës, si:
  - o udhëzuesi për raportim narrativ dhe financiar për projektet e subvencionuara;
  - o formulari për raportim financiar;
  - o rregullorja për mbrojtje nga zjarri (DODONË);
  - o udhëzuesi për kërkim të pëlqimit për shfrytëzim të hapësirës.
- Tenderimi i projektit për shkrim në alfabetin e BRAIL-it;
- Vlerësimi dhe vendimi për anulim të tenderit të projektit për digjitalizimi të procesit të aplikimit për subvencione.

ARKIVI I KOMUNAL gjatë muajit dhjetor ka vazhduar punën sipas planit të punës në rregullimin e materialit arkivorë:

- Fondi “Avokatura Publike”;
- Regjistrimin e librave amë në mënyrë elektronike të shkollës së mesme “7 Shtatori”;
- Takim me Drejtorinë e Pronës në Komunën e Prishtinës lidhur me dokumentacioni arkivor, ku u dakorduan që material të dorëzohet në Arkivin Komunal të Prishtinës gjatë muajit dhjetor.

BIBLIOTEKA “HIVZI SULEJMANI”:

- Dega: “Biblioteka Përkujtimore” në bashkëpunimin me Këndin Amerikan, këtë vit ka realizuar aktivitete shume frytdhënëse. Ky bashkëpunim mes dy institucioneve është gërshetuar me shumë të mira, duke krijuar në bibliotekë ambiente të edukimit joformal, nxitjen e fëmijëve për të marrë pjesë në këto aktivitete, ligjërata në gjuhën angleze, me punëtori kreative dhe lojëra te cilat janë të përshtatshme për moshën e tyre. Ligjëruesit vullnetarë në këto aktivitete po fitojnë eksperiencë për të vazhduare rrugëtimin e tyre. Fëmijët kanë pasur mundësi të shohin film 3D me syze 3D, dhe është bërë prezantimi i printerit 3D. Gjatë punës me printimin 3D, fëmijët janë familjarizuar me terminologjitë e pjesëve të printerit, procesit të printimit dhe mjeteve tjera të printimit. Në fund kanë parë objektin 3-dimenzional të printuar. Në realizimin e këtij projekti studentët vullnetarë më shumë se 6 muaj kanë mbajtur ligjërata javore në “Bibliotekën Përkujtimore”. Ata kanë mësuar gjuhën angleze përmes aktiviteteve interaktive, lojëra, prezantimeve, zhvilluan aftësitë e reja në teknologji, aftësi biznesi dhe marketing.
- Aktiviteti në ndihmë të fuqizimit të nënave dhe ndihmën që u ofroi “Biblioteka Përkujtimore” në mësimin e lexim –shkrimit, përfundoi me një takim të nënave në Këndin Amerikan. Gjatë

- këtij takimi në Këndin Amerikan atyre u ofruan informacione nga studentët vullnetarë për njohuri bazike në ushtrime të shkrim-leximit elektronik në kompjuter përmes programeve të Office (Word dhe Excel), të cilat u certifikuan për pjesëmarrjen në këtë projekt.
- Në “Bibliotekën Përkujtimore” pati vizitë nga shkolla “Elena Gjika”, pesë mësuese, të cilat kanë shprehur dëshirën që tek fëmijët e klasës së parë të nxisin kureshtjen për të ardhur në biblioteka, për të nxitur, motivuar dhe krijuar shprehin e të lexuarit

#### TEATRI I QYTETIT TË PRISHTINËS “DODONA”

- Realizimi i 4 shfaqjeve të rregullta në skenën e teatrit të kukullave;
- Realizimi i shtatë shfaqjeve në skenën për të rritur;
- Realizimi i 3 premierave “Aromë femre”, “Sapotlem” dhe “Lojë e pafund”;
- Realizimi i shfaqjes me tematikë Vitin e Ri;
- Realizimi i 4 programeve të tjera.
- Gjithsej 88 shfaqje (programe/ aktivitete)

#### QENDRA KULTURORE E FËMIJËVE

- Të gjithë sektorët janë përfshirë në përgatitjet intensive për realizimin e programit festiv dedikuar Festës së Vitit të Ri. Ky program ishte edhe përmbyllje e aktiviteteve kalendarike për këtë vit sa i përket planprogramit të QKF-së, pasi që edhe fëmijët në të gjitha sektorët, do të jenë në pushimin dimëror;
- Realizimi i programit festiv për festat e fundvitit nga Qendra Kulturore e Fëmijëve të Prishtinës, mbajtur në TQP “Dodona”;
- Klubi i Ambasadorëve të Rinj pati një program (performancë artistike) dedikuar festës së Vitit të Ri, ku për u përfshinë urimet dhe mesazhe (simbolike dhe pozitive) drejtuar fëmijëve dhe gjithë moshatareve të tyre, në mënyrë që viti i ardhshëm të jetë edhe më i lumtur në krahasim më vitin që po e lëmë pas;
- Janë duke u përgatitur formularët për pranim dhe dorëzimin e garderobës nga fëmijët në Qendrën Kulturore të Fëmijëve të Prishtinës;
- Është bërë regjistrimi i inventarit dhe kane filluar përgatitjet për regjistrimin e gardërobës;
- QKF ka filluar përgatitjet për zgjerimin e aktiviteteve në kuadër të sportit, themelimi i grupit “Badminton”.

#### **Rini dhe Sport:**

- Komisioni për organizimin dhe identifikimin e artistëve për pjesëmarrje në shënimin e festës së 28 Nëntorit dhe festave dhe organizimeve të tjera kulturore deri në fund të vitit 2016, i caktuar sipas Vendimit 01. nr. 031- 288107, më 23.11.2016, ka organizuar takime të rregullta rreth plan programit të punës së Drejtorisë së Kulturës për aktivitetet/festat e fund vitit, përfshirë këtu aktivitetet e ndryshme kulturore-sportive të festës së flamurit, koncertet javore me solistë dhe

grupe muzikore të rinjë, me qëllim të promovimit të tyre, parapërgatitjet për sportistin e vitit, si dhe programi i Vitit të Ri.

- Për realizimin teknik të aktiviteteve të lartpërmendura, DK ka realizuar një kontratë kornizë, në mbikëqyrjen e dy zyrtarëve të DK-së, të cilat në bashkëpunim me komisionin e lartcekur, kanë përzgjedhur performuesit e rinj për realizimin e koncerteve javore që janë zhvilluar me sukses gjatë muajit dhjetor 2016. Zyrtarët në fjalë kanë monitoruar projektin “Promovimi i artisteve të rinj” çdo të merkurë, të premte dhe të shtunë.
- Mbikëqyrje dhe monitorimi i punëve në dekorimin e qytetit.
- Organizimi i turneut tradicional të shahut “Memoriali Hyzri Talla”, aktivitet ky i cili mbahet me mbështetjen dhe nën patronatin e Komunës së Prishtinës për vite me radhë. Në këtë turne pjesëmarrës ishin shahistë nga vendi dhe rajoni.
- Gjatë muajit dhjetor, janë bërë përgatitjet finale rreth organizimit të ngjarjes sportive “Sportisti i vitit 2016”, e cila është mbajtur më 27 dhjetor. Organizimi i këtij manifestimi sportiv ka për qëllim përmblylljen e aktiviteteve sportive, si dhe vlerësimin e sportistëve të cilët për gjatë tërë vitit kanë kontribuar në arritjen e rezultateve kulmore në garat e ndryshme sportive në vend dhe jashtë vendit. Po ashtu janë shpërblyer edhe punëtorët sportiv, trajnerë, gjyqtarë si dhe janë shpërblyer edhe personalitete të cilët kanë kontribuar në zhvillimin e sportit në përgjithësi.

#### **4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR**

*Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues*

##### **Rini dhe Sport:**

- Pas përmblylljes së thirrjes për aplikim, janë bërë parapërgatitjet rreth selektimit të projekteve të cilat kanë aplikuar për subvencionim, bazuar në kriteret e përshkruara në thirrjen për aplikim, si dhe organizimi i mbajtjes së takimeve me Komisionin e caktuar për ndarjen e subvencioneve për shqyrtimin e tyre.
- Parapërgatitjet finale për finalizimin e punimeve në këndet e lodrave për fëmijë në lagjet “Kodra e Trimave”, “Dardania” dhe “Bregu i Diellit”.

#### **5. STATISTIKAT**

*Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës*

### *5.1.1. Buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese 2016*

- Pas shqyrtimit të projekteve të klubeve sportive dhe OJQ-ve rinore për fazën e fundit për vitin 2016, komisioni për shqyrtimin e kërkesave ka propozuar për përkrahje 30 projekte nga fusha e sportit dhe 2 projekte rinore.  
Shuma totale që është shpenzuar për këto projekte ka qenë 37,224€.

### *5.1.2. Takimet me palë*

#### **Kulturë:**

- DK në vazhdimësi ka takime me qytetarë lidhur me:
  - o kërkesat për subvencionim;
  - o pajisje me pëlqime për mbajtjen e aktiviteteve.

Konsultime për çështje kulturore, si dhe informacione bazuar në nevoja të Drejtorisë në lidhje me koncertet e të rinjve.

#### **Rini dhe Sport:**

- Takim me përfaqësuesit e Qendrës Rinore dhe Këshillit të Veprimit Lokal Rinore, për koordinimin e punëve për muajt nëntor – dhjetor.
- Takime me përfaqësues të klubeve sportive të kryeqytetit, për të diskutuar rreth nevojave dhe kërkesave të ndryshme në fushën e sportit, përfshirë këtu edhe kërkesat për regjistrim të klubeve sportive në regjistrin e klubeve publike që posedon Sektori ynë, si dhe kërkesat rreth mundësisë së financimit të tyre për sezonin vjeshtor të vitit 2016.

### *Takimet me institucionet e tjera*

#### **Kulturë:**

- Takim pune me komisionin për tregun e fundvitit;
- Vizitë degës “Përkujtimore” nga shkolla “Elena Gjika”;
- Takim në UNDP rreth projektit të digjitalizimit të subvencioneve.

### *5.1.3. Diskutime Publike/Takimet me qytetarë*

### *5.1.4. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare*

#### **Kulturë:**

- Kërkesa e Fondacionit kulturorë “IBRAHIM KODRA” për qasje në dokumentacionin e planimetrisë së objektit të vjetër të bibliotekës, e cila është dërguar te Drejtorja e Pronës.

#### 5.1.5. Lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër

##### **Kulturë, Rini dhe Sport:**

- Pranimi i kërkesave, adresimi i tyre dhe mbajtja e evidencës, bëhet në baza ditore, si dhe protokollohen në librin e protokollit të shkurtë.

##### **Rini dhe Sport:**

- Janë pranuar lëndë, kryesisht kërkesa për financim, rreth 69 sosh, ku prej tyre 12 kanë qenë projekte/kërkesa rinore, ndërsa 57 të klubeve sportive.

#### 5.1.6. Takime të tjera

### 6. SFIDAT

*Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, psh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.*

##### **Kulturë:**

- Për shkak të temperaturave të ulëta dhe mosfunksionimit të plotë të sistemit të ngrohjes qendrore në objektin e ri të Bibliotekës, ka pasur rënie të vogël të lexuesve në këtë objekt.
- Realizimi i tenderit për furnizim me libra për bibliotekën "Hivzi Sulejmani".

### 7. REKOMANDIME

*Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë, etj.*

##### **Kulturë:**

- Teatri "Dodona" ka nevojë për organizimin e trajnimeve për mbrojtje nga zjarri për rojet dhe kujdestarët e ditës;
- Nevojë për pajisje të teatrit me kompjuter, ndriçim, fotokopje, zërim etj.;
- Servisimin e aparateve për mbrojtje nga zjarri;
- Trajnime të stafit të Bibliotekës për organizimin e fondit dhe hapësirave në objektin e ri dhe njohuri për shërbime të reja;
- Nevojë për pranimin e punëtorëve të rinj në Bibliotekë.

### 8. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES



## **Kulturë:**

- Realizimi i planit të veprimit për vitin 2017;
- Përgatitja e projekteve për tenderim;
- Përpilimi i rregulloreve dhe udhëzuesve të punës për drejtori, si dhe institucione vartëse;
- Planifikimi i festës për 17 shkurtin, Ditën e Pavarësisë së Kosovës;
- Pagesa e subvencioneve të mbetura nga viti paraprak;
- Pranimi, shqyrtimi dhe përfundimi i lëndëve ditore;
- Kontrollimi i raporteve narrative dhe financiare për projektet e subvencionuara;
- Përfundimi i formularit për aplikim për subvencione;
- Përpilimi i thirrjeve për aplikim për subvencione;
- Shpallja e thirrjeve për aplikim;
- Regjistrimi i kërkesave për subvencionim;

## **Rini dhe Sport:**

- Realizimi i planit të veprimit për vitin 2017;
- Përgatitja e projekteve për tenderim;
- Vlerësimi i tenderit për Kontratën kornizë për “Renovimin dhe mirëmbajtjen e terreneve sportive dhe këndeve të lodrave në komunën e Prishtinës”;
- Grumbullimi i të dhënave nga klubet publike sportive, të cilat janë të regjistruara në Komunën e Prishtinës përmes “Formularit të sportit komunal 2017”, praktikë kjo e cila aplikohet çdo fillim vit;
- Kontrollimi i raporteve narrative dhe financiare për projektet e subvencionuara;
- Përfundimi i formularit për aplikim për subvencione;
- Përpilimi i thirrjeve për aplikim për subvencione;
- Shpallja e thirrjeve për aplikim;
- Regjistrimi i kërkesave për subvencionim;

## **9. TË TJERA**

10. Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen, e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.